



47

IRDK

Të bashkuar

ndërtojmë të ardhmen

Programi zgjedhor

08 Qershor 2014

IRDK, 2014

47

IRDK

Të bashkuar ndërtojmë të ardhmen

Inciativa e Re Demokratike e Kosovës si përfaqësuese e parë politike e egjiptianëve të Kosovës, angazhimin politik e ka vendosur në rend të parë në ruajtjen dhe avancimin e qenies kombëtare të egjiptianëve të Kosovës dhe në përmirësimin e pozitës së tyre në shoqërinë e Kosovës. Arritja e objektivave që kemi gjithmonë nuk është e lehtë dhe të realizueshme prandaj duhet edhe shumë mund dhe energji për të arritur në pozitën e merituar. IRDK gjithmonë ka qenë dhe është e hapur për të gjithë ata që kanë vullnet të mirë për të punuar për të mirën e popullit tonë, për ata që kanë dituri dhe për ata që kanë ndjesi më të theksuara patriotike.

Ne që filluam me Shoqatën "Shqiptaro-Egjiptiane" pas vitit 1999 dhe pastaj themeluam IRDK, ne nuk e kemi ndërmend që të ndalemi këtu sepse nuk e filluam këtë punë që të arrijmë në pozitën që jemi tani. IRDK si udhërrëfyese e vetme në Kosovë e egjiptianëve të Kosovës ka nevojë për mbështetje masive të Egjiptianëve të Kosovës, në mënyrë që të jetë e fortë dhe e qëndrueshme.

47 IRDK

Pikat programore për zgjedhjet parlamentare me 8 Qershor 2014



**Mbrojtja dhe promovimi i
identitetit etnik**



**Mbrojtja dhe avancimi i të
drejtave të njeriut**



Arsimimi dhe Edukimi



Përmirësimi i infrastruktures



**Mbështetja për bizneset e
vogla dhe të mëdha**



**Qasja të barabartë në
medime publike**

47

IRDK



**Mbrojtja dhe
promovimi i
identitetit etnik**



IRDK



Identiteti etnik i veçantë i Egjiptianëve të Ballkanit, për Egjiptianët e Kosovës duhet në vazhdimësi që të mbrohet dhe promovohet. Vënia në fokus me qëllim të zbehjes dhe dëmtimit të identitetit të veçantë etnik të Egjiptianëve të Kosovës nga qarqe të caktuar, identifikimi i Egjiptianëve të Kosovës me shkurtesa, vazhdimi i identitetit Egjiptian dhe Ashkali për të njëjtin grup etnik janë arsyt kryesore që IRDK, Identitetin Etnik e ka top prioritet të programit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare të 8 Qershorit 2014.

Mbrojtja dhe promovimi i identitetit etnik ishte arsyeja kryesore e daljes në skenë të IRDK-së në vitin 2001, IRDK ishte gardian i mbrojtjes së identitetit etnik, ka denoncuar publikisht tendencat për përziye të egjiptianët me grupet tjera etnike, ka qenë e kujdesshme gjatë hartimit të kornizës ligjore.

Fakti se grupi etnik i Egjiptianëve të Kosovës është në proces të pranimit të këtij identiteti, për shkak se Egjiptianët e Kosovës dhe rajonit në qarqe të ndryshme identifikohen me romët (tjeret), fakti se jemi të ndarë në egjiptian dhe ashkali, IRDK gjatë katër vitet e ardhshme të përfaqësimit të Egjiptianëve të Kosovës në Parlamentin e Kosovës do të angazhohet për: përafrimin e egjiptianëve me ashkalitë me qëllim që në vitin 2021 të regjistrohemi si një grup etnik, koordinimin e Egjiptianëve të Ballkanit, vendosja e komunikimit me shtetin e Egjiptit.

1.1. Përafrimi me ashkalitë

Pajtimi i liderëve politik dhe të shoqërisë civile për fillimin e bisedimeve vendos bazën e përafrimit dhe arritjen e qëllimit final të bashkimit. IRDK konsideron që akterët kryesor nga ana e Egjiptianëve dhe Ashkalive duhet ndjekur parimet vijuese:

- *Praktika për të mundur njëri tjetrin duhet të ndalet dhe në vend të kësaj duhet të filloj një epokë e re e komunikimit me qëllim të përafrimit.*

- *Egjiptianët dhe ashkalitë janë i njëjti popull dhe të njëjta gjë duhet të konfirmohet edhe nga ana e ashkalive.*

- *Interesi madhor i komunitetit të ndarë në egjiptian dhe ashkali është pajtimi për fillimin e përafrimit të komunitetit përmes bashkëpunimit për një koncept të përbashkët për integrimin dhe përparimin e komunitetit tonë në shoqërinë e Kosovës.*

- *Të gjithë përfaqësuesit e komunitetit, në organizatat politike dhe të shoqërisë civile në Kosovë, duhet të kenë përgjegjësi për veprimet dhe për mos veprimet e duhura, dhe duhet ndërmarrë hapa të guximshëm dhe konkret për interesin e përbashkët nacional.*

- *Shpjegimet mbi prejardhjen etnike dhe simbolet e deklaruara në publik nuk duhet të jenë pengesë për krijimin e afërsisë dhe bashkimit si grup i njëjtë etnik.*



IRDK do të angazhohet për harmonizimin e qëndrimeve me përfaqësuesit politik të ashkalive në Parlamentin e Kosovës dhe në mekanizmat tjerë qeverisës me qëllim të mbrojtjes dhe avancimit të identitetit tonë etnik. IRDK do të insistoj që në Kushtetutë dhe në Ligje të eliminohen pengesat formale që ndajnë egjiptianët dhe ashkalitë.

Me qëllim të përafrimit, IRDK në vazhdimësi do të insistoj për krijimin e një Këshilli të përbashkët, puna e të cilit do të udhëhiqej nga parimet e shënuara më lartë, dhe i cili do të krijonte kushtet dhe rrethanat e përshtatshme për komunikim dhe përafrim të mirëfilltë.

Qëllimi final do të jetë që regjistrimi i popullsisë në vitin 2021 edhe formalisht të jetë për grupin e njëjtë etnik.

1.2. Koordinimi i Egjiptianëve të Ballkanit

Me qëllim të përmirësimit të pozitës së Egjiptianëve në shtetet e Ballkanit: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Mali i Zi e vende tjera, IRDK mbështet idenë e ristrukturimit apo krijimit të mekanizmave koordinues për Egjiptianët e Ballkanit. Bashkëpunimi rajonal duhet mbështetur në qëllim të koordinimit të veprimeve për respektimin e të drejtave dhe lirive, luftimin e paragjyqimeve dhe stereotipeve, avancimin e përfaqësimit institucional të Egjiptianëve, bashkëpunim kulturor, bashkëpunim të bizneseve, bashkëpunim në shkollim dhe fusha tjera me interes të përbashkët.

IRDK do të mbajë, të paktën një herë në vit, një Forum me Egjiptianët e Ballkanit nga i cili do të dalin konkluzione të cilat shërbejnë për avancimin e pozitës së Egjiptianëve në shoqëritë e shteteve ku jetojnë.

1.3. Vendosja e lidhjeve me shtetin e Egjiptit

Pas normalizimit të situatës në shtetin e Egjiptit, do të vendosen marrëdhëniet diplomatike në mes të Kosovës dhe shtetit të Egjiptit. Kjo do të krijoj kushtet e përshtatshme për fillimin e komunikimit të Egjiptianëve të Kosovës me institucionet shtetërore të Egjiptit. Në fazën fillestare të IRDK do të insistoj për vendosjen e bashkëpunimit ekonomik me qëllim të krijimit të kushteve nga ana e shtetit të Kosovës për investime nga Egjipti, vendosjen e bashkëpunimit kulturor përmes organizatave kulturore nga Kosova dhe Egjipti, krijimi i lehtësirave për shkollimin e të rinjve tanë në Egjipt.

Synimet e IRDK-së për vendosjen e lidhjeve me shtetin e Egjiptit do të jenë të mundshme pasi që në një të ardhme të aferë presim hapjen e ambasadës së Egjiptit në Kosovë dhe bashkëpunimi ndërshtetëror e vendos në pozitë të mirë përfaqësuesin e IRDK-së në Parlament për arritje të synimeve.

47

IRDK



**Mbrojtja dhe
avancimi i të
drejtave të njeriut**



IRDK



Baza ligjore në Kosovë garanton të drejta të bazuara në Konventat ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut. Për mbrojtjen e të drejtave të Egjiptianëve të Kosovës, IRDK do të përdor mekanizmat institucional në Parlamentin e Kosovës: Komisionin për të drejtat e komuniteteve, Këshillin Konsultativ për Komunitete në Presidencën e Kosovës, Avokatin e Popullit, Komitetet për Komunitete në nivelin lokal dhe mekanizmat tjerë në këtë fushë. Për këtë qëllim nevojitet mbledhja e fakteve për diskriminim me motive etnike, raportimi i fakteve në mekanizmat ekzistues.

2.1. Mbledhja e fakteve për diskriminim

Në kuadër të Kryesisë së IRDK-së do të themelohet Komiteti për mos diskriminim i cili do të grumbulloj të dhëna dhe fakte për të gjitha format e diskriminimit që do të bëhen nga institucionet shtetërore. Grumbullimi i informatave për diskriminim do të bëhet duke publikuar një adresë elektronike, një numër telefoni ose përmes përfaqësuesve lokal në Komitetet për Komunitete.

2.2. Raportimi i diskriminim

Përfaqësuesit politik në Parlamentin e Kosovës dhe përfaqësuesit në nivel lokal të IRDK do të raportojnë faktet e mbledhura nga Komiteti për mos diskriminim. Përfaqësuesit politik të IRDK-së do të marrin rekomandime nga Komiteti për mos diskriminim lidhur me adresën për raportim, për argumentimin ligjor të shkeljeve. Raportimi mbi diskriminimin dhe shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut do të bëhet në institucionet për mbrojtje të drejtave të njeriut, medie dhe organizatat ndërkombëtare.

47

IRDK



**Arşimimi dhe
edukimi**



Shkalla e përparimit të komunitetit Egjiptian në të ardhmen varet nga shkalla e shkollimit të gjeneratës së re. Sikurse në të kaluarën, edhe tani IRDK do të ketë angazhime për vijueshmërinë e shkollimit në nivelin fillor (para shkollor, dhe fillor), të mesëm dhe superior. Sfida kryesore në shkollimin e komunitetit do të mbetet regjistrimi i të gjithë fëmijëve në nivelin para shkollor dhe fillor, mos braktisja e shkollimit dhe vazhdimi i shkollimit të mesëm dhe të lartë.

3.1. Regjistrimi i fëmijëve në nivelin parashkollor dhe fillor

Drejtoritë komunale të Arsimit duhet të bëjnë fushatë informuese lidhur me afatet për regjistrimin e fëmijëve në nivelin parashkollor dhe fillore, konform afateve kohore të specifikuar me ligj. Në këtë kuadër, Drejtoria komunale e Arsimit, bazuar në regjistrat civil duhet njoftuar me shkrim secilin prind 30 ditë para afatit për regjistrim të fëmijës në parashkollor dhe klasën e parë të nivelit fillor.

3.2. Parandalimi i braktisjes së shkollimit

Fenomeni i braktisjes së shkollimit, në veçanti i shkollimit fillor, është dukuri që përcjell komunitetin Egjiptian. Kjo dukuri e dëmshme për fëmijët, familjen, komunitetin dhe shoqërinë është e theksuar në veçanti të familjet që jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Edhe pse shkollimi fillor është sanksionuar si obligativ, shqiptimi i dënimeve për mosvijimin e mësimit apo braktisje nuk është praktikuar për shkak të moskoordinimit e drejtorive komunale të arsimit (inspektoratit të arsimit) dhe gjykatave. Parandalimi i braktisjes së shkollimit dhe vijueshmëria e mësimit të familjet që jetojnë në kushte të renda sociale dhe fëmijët jetim është komplekse dhe duhet zbatuar masa të caktuar për parandalimin e kësaj dukurie. Për këtë dukuri, Qeveria e Kosovës duhet ndarë buxhetin në shumën prej 600 000 euro në vit për stimulimin e 1000 familjeve me kushte të renda ekonomike për t'i dërguar fëmijët e tyre në shkollë duke iu siguruar nga 50 euro në muaj. Kushtëzimi i dhënies së stimulimit me vijueshmëri të shkollimit fillor do të zvogëlojë në masë të madhe dukurinë e braktisjes së shkollimit fillor.



3.3. Shkollimi i mesëm

Konkurrenca nganjëherë e përballueshme për regjistrim në shkollën e mesme të nxënësit e komuniteti Egjiptian karshi komuniteti shumicë shtron nevojën e rezervimit të 5% te vendeve për nxënësit e komunitetit Egjiptian në shkollat e mesme në gjuhën shqipe. Në 5 përqindëshin e rezervuar duhet lejuar konkurrencën e nxënësve të komunitetit Egjiptian.

IRDK konsideron se shkollimi i nxënësve të komunitetit Egjiptian në shkollat profesionale krijon parakushte për punësim më të lehtë pas përfundimit të shkollës së mesme.

IRDK në vijim do të angazhohet për ndarjen e fondeve nga Ministria e Arsimit për nxënësit e komunitetit Egjiptian.

Shkollimi i mesëm në programin zhvillimor dhe ngritjes profesionale të IRDK-së është shtyllë shumë e rëndësishme. Shkollat e Mesme Profesionale do të jenë në fokus te programit 4 vjeçar të IRDK-së për krijimin e gjeneratave të reja profesionale të cilet nga njohurit profesionale të fituara gjatë shkollimit dhe mbeshtejn institucionale që do të përfitojnë nga Qeveria e Kosovës më angazhimin e IRDK-së do të krijohen mundësitë e zhvillimit të bizneseve individuale nga gjenerata e re.

3.4. Shkollimi i lartë

IRDK sikurse deri me tani do të veproj për krijimin e lehtësirave për regjistrim të studenteve të komunitetit Egjiptian në nivelin e shkollimit të lartë. Krijimi i lehtësirave për regjistrim të studenteve duhet të sanksionohet me ligj ku rreth 3% e numrit të përgjithshëm te studenteve duhet rezervuar për komunitetin Egjiptian.

IRDK rekomandon krijimin e klubit të studenteve Egjiptian që do të ishte lidhje në mes tyre me qëllim të bashkëpunimit, ofrimin e ndihmës për njeri tjetrit, interesimi për bursa dhe forma tjera të bashkëpunimit me qëllim të arritjes së sukseseve në studime dhe faktorizimin e studeteve egjiptian në Senatën e Universiteteve Publike.

Në fokus të programit të IRDK-së do të jetë regjistrimi dhe mbështetja e studenteve të rinj të kategorisë deficitare në komunitet dhe të cilët konsiderohen si kuadro Strategjike në avancimin dhe promovimi e identitetit dhe kultures të egjiptianeve në Ballkan.

Në bashkë koordinim me Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë do të krijohet një program i veçantë për përgatitjen e kuadrove deficitare në Universitetet Publike në Kosovë dhe jashtë Kosovës në fushatën e Etnologjisë, Historisë, Orientalistikës, Egjiptologjisë, Edukim-Pedagogjik, Media dhe Komunikimi Masiv. Nga ky program këta student do të beshten me bursë studimi nga institucionet vendore dhe nderkombetare.

47

IRDK



Përmirësimi i infrastrukturës

Me gjithë disa përparime në dhjetëvjetëshin e fundit në përmirësimin e infrastrukturës në vendbanimet ku është i përqendruar komuniteti Egjiptian, nevoja për investime në këtë drejtim është ende e madhe.

Përfaqësuesit e IRDK-së në institucionet qendrore do të hartojnë dokumentin me nevojat prioritare në vendbanimet ku është përqendruar komuniteti Egjiptian në Pejë, Gjakovë, Istog, Klinë Prizren, Fushë Kosovë, Rahovec, Deçan dhe në vendbanime tjera.

Në projektet kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Zyra për komunitete pranë Kryeministrit dhe ministri tjera do të përfshihen projektet prioritare për komunitetin Egjiptian.

IRDK konsideron se për përmirësimin e kushteve të komunitetit egjiptian, Qeveria e Kosovës duhet ndajë për çdo vit nga 800 000 euro. Investimet e këtij buxheti duhet përfshijnë financimin e projekteve për furnizim me ujë të pijshëm, kanalizimin e ujërave të zeza, asfaltimin e rrugëve në lagjet dhe fshatrat e koncentruar me komunitetin egjiptian, ndriçimi publik etj.

47

IRDK



Deri në arritjen e duhur të zhvillimit ekonomik, që do të rezultonte në zhvillimin e sektorit privat dhe rritjen e tregut të punës, IRDK konsideron se do të kaloj edhe një periudhë jo shumë e shkurtër. Marrë parasysh se Kosova aktualisht është shteti më i varfër në Evropë, komuniteti Egjiptian i Kosovës, edhe për shkak të ngecjes nga e kaluara, është në gjendje të pa volitshme.

Pa punësia e cila sillet rreth 90% në komunitet është e dhënë që shteti duhet ndërmarrë masa për të shpërberë këto shifra alarmante. Aktualisht, institucionet ndajnë donacione në fushën e bujqësisë, dhe grande të caktuara për biznese. IRDK insiston në uljen e kriterëve, për pjesëtarët e komunitetit Egjiptian, të parashtruara si kushte për përfitimin e donacioneve dhe subvencioneve.

IRDK do të insistoi te zyra e Bashkimit Evropian dhe zyrat e ambasadave në Kosovë për participimin e komunitetit Egjiptian në fondet që pritet të ndahen gjatë fazave të ardhshme si ndihmë Kosovës për integritime evropiane.

Ulja e nivelit të kriterëve të subvencionet e Qeverisë së Kosovës për komunitetin Egjiptian, participimi në fondet zhvillimore të Komisionit Evropian, investimet e diasporës për hapjen e bizneseve janë angazhimet e IRDK në të ardhmen për mbështetje të fermerëve dhe bizneseve tjera.

IRDK, më inkuadrimit në Qeverinë e Re të Republikës së Kosovës, do të angazhohet në krijimin e një task force në përbërje të ministrive relevante dhe institucioneve tjera vendore, mandati i të cilit do të jetë luftimi i shkallës së lart të papunësisë në komunitet në krijimin e ndërmarrjeve të reja dhe mbështetjen e atyre ekzistuese në krijimin e vendeve të reja të punës. Ky program do të përfitoj dhe nga fondet e Bashkimit Evropian aktual dhe nga qasja në program të reja të BE-së të cilat Kosova do të ketë qasje në proceset e përafrimit më BE-në.

47

IRDK



Qasje e barabartë në medime publike

E drejta për qasje të garantuar dhe përfaqësim të veçantë në mediet transmetuese publike e garantuar me Nenin 59, pika 10 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për komunitetin Egjiptian të Kosovës nuk është respektuar deri me tani.

Mos informimi lidhur me aktivitetet e subjekteve politike që përfaqësojnë Egjiptianët e Kosovës, neglizhimi i komunikatave publike, përfshirja e komunitetit Egjiptian në akronimin me motive raciste RAE, mos informimi lidhur me aktivitetet kulturore për komunitetin Egjiptian nga ana e mediumit publik Radiotelevizioni i Kosovës, është shkelje e ligjeve të aplikueshme në Kosovë. Sipas Nenit 5, pika 2c e Ligjit të Radiotelevizionit të Kosovës thuhet se RTK garanton realizimin e të drejtave të të gjithë banorëve të Kosovës në fushën e informimit publik dhe të ruajtjes dhe kultivimit të gjuhës, kulturës dhe karakteristikave tjera të tyre. Gjithashtu në Nenin 6, pika 4 e këtij ligji thotë së Standardet programore do të promovojë kulturën shqiptare dhe të komuniteteve të tjera që jetojnë në Kosovë, si dhe do të nxisë krijimtari kulturore dhe krijimtari tjera artistike. Në Nenin 6, pika 6.2 te Ligji për Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre ndër të tjera thuhet se komuniteteve iu garantohet qasje dhe përfaqësim i barabartë në mediat publike transmetuese.



IRDK



Duke e analizuar bazën ligjore që garanton informimin nga ana e medimeve publike, konstatojmë se RTK si medium i vetëm publik në Kosovë, nuk respekton ligjet e miratuara dhe shkel të drejtat e garantuara. Prandaj IRDK është e përkushtuar në zbatimin e ligjshmërisë që ka të bëjë me të drejtën për informim të komunitetit Egjiptian në Kosovë.

Specifikat e komunitetit Egjiptian në Kosovë, siç është gjuha amtare shqipe, bëjnë që Egjiptianët e Kosovës janë të informuar me lajme në përgjithësi. Mirëpo lajmet e transmetuara nga mediumi publik RTK, nuk përfshijnë asgjë që kanë të bëjnë me komunitetin Egjiptian, ose shpesh e cenojnë identitetin etnik të Egjiptianëve. Prandaj IRDK është e përkushtuar që në mediumin publik RTK:

- Të transmetohet një kronikë e veçantë për komunitetin Egjiptian të Kosovës.
- Kronika të përgatitet nga të punësuarit e kualifikuar dhe trajnuar të RTK-së që vijnë nga pjesëtarët e komunitetit Egjiptian të Kosovës.
- Kronika të transmetohet një herë në javë në RTK kanali 1 në një orar të përshtatshëm.

Në kuadër të qasjes së barabartë në mediet publike, IRDK do të angazhohet që Komuniteti egjiptian i Kosovës në Mediumin Publik dhe ato Privat të këtë raportim dinjitoz dhe jo racist, prioritet i IRDK-së do të vazhdoj të jetë luftimi i akronimit racist RAE në mediet e Kosovës, në bashkëpunim me Asociacionet e Medimeve të Kosovës, Komisionit të Pavarur për Media dhe gjithë institucioneve relevante vendore që të përfshihet në Kodin etik të Gazetarisë.



IRDK



Të bashkuar ndërtojmë të ardhmen